



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENT" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 707/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092), në përbërje nga panelisti individual, Agon Ramadani - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i Operatorit Ekonomik (GOE) n.sh "Ambulanca Veterinare Indriti" & "Ambulanca dhe Farmacia Veterinare Goni", me seli në Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Trajtimi e qenëve endacak" me nr. të prokurimit: 613-22-11339-2-3-6 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Lipjan, me datën 20.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet, si e pa bazuar ankesa e parashtruar nga grupi i Operatorit Ekonomik n.sh "Ambulanca Veterinare Indriti" & "Ambulanca dhe Farmacia Veterinare Goni", me seli në Ferizaj, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 29.11.2022 (me numër protokolli 707/2022) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Trajtimi e qenëve endacak" me nr. të prokurimit: 613-22-11339-2-3-6 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Lipjan, ndërsa mbetet në fuqi Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës për këtë aktivitet të prokurimit.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj Panelin Shqyrtues të OSHP, për gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi. Në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar).

IV. Me qenë se ankesa e grupit të Operatorëve Ekonomik n.sh “Ambulanca Veterinare Indriti”&“Ambulanca dhe Farmacia Veterinare Goni”, me seli në Ferizaj, i refuzohet si e pa bazuar, i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 21.11.2022, Komuna e Lipjanit , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B58 Njoftimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Trajtimi e qenëve endacak” me nr. të prokurimit: 613-22-11339-2-3-6,ku është rekomanduar për kontratë OE "Ambulanca Veterinare Drenas" me seli në Glllogoc.

Me datë 22.11.2022,grupi i Operatoreve Ekonomik n.sh “Ambulanca Veterinare Indriti”&“Ambulanca dhe Farmacia Veterinare Goni”, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Komuna Lipjan, me datë 23.11.2022, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin e datës 21.11.2022 të Autoritetit Kontraktues Komuna Lipjan.

Me datën 29.11.2022 grupi i Operatorëve Ekonomik n.sh “Ambulanca Veterinare Indriti”&“Ambulanca dhe Farmacia Veterinare Goni”, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 707/2022, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbime; vlera e parashikuar e kontratës: 9,900.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Raporti i ekspertit shqyrtues është pranuar nga të dyja palët me ç'rast OE është pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa AK Kuvendi Komunal Lipjan nuk është pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit

të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 12.12.2022, eksperti i jashtëm shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa grupit të Operatorëve Ekonomik n.sh “Ambulanca Veterinare Indriti”&“Ambulanca dhe Farmacia Veterinare Goni” të aprovohet si e bazuar.
- të anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK-së për aktivitetin e prokurimit të lartë cekur dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

-Seanca dëgjimore-

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrësit e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Vlerësimi i ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin e bashkangjitur nga OE ankues dhe atë të lëndës së aktivitetit në fjalë konsideron se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar. OE, ankuesi ka dorëzuar një marrëveshje valide dhe një aneks marrëveshje për shfrytëzim të eskavatorit nga një biznes individual së bashku me dëshmitë përcjellëse (faturën e blerjes) dhe foto sipas kërkesave të DT përkatësisht FDT-se.

Eksperti konsideron se arsyetimi i AK sipas të cilit OE në kërkesën për sqarime nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara sipas kërkesës në fjalë përkatësisht se sqarimet e dhëna nuk përmbushin kërkesat e AK lidhur me këtë pjesë me aludimin se i njëjti ka ofruar një marrëveshje angazhimi të eskavatorit për një aktivitet tjetër prokurimi është i pa qëndrueshëm sepse fillimisht një kërkesë e tillë nuk është specifikuar në DT përkatësisht në FDT e po ashtu nga aneksi i marrëveshjes për kryerjen e shërbimeve të gruposjes përkatësisht shfrytëzimin e automjetit shihet qartë se është e pa kufizuar për të gjitha komunat e Kosovës, dhe vlen për të gjitha rastet dhe sipas nevojave /kërkesave të porositësit (OE ankues në rastin konkret).

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Konstatimet e Panelit shqyrtues-

Paneli shqyrtues duke u bazuar ne dokumentacionin e bashkangjitur nga OE ankues dhe atë të lendes se aktivitetit ne fjalë, raportit të ekspertit të jashtëm shqyrtues, vlerëson se pretendimi ankimor i OE ankues nuk është i qëndrueshëm, për faktin se dokumentacioni i ofruar në sqarimet shtesë është ofruar pas hapjes së ofertave dhe jo së bashku me ofertën.

Si çështje kyçe përcaktuese që ka sjellur deri tek vendimmarrja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi ka qenë eliminimi i OE ankues mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar në ankesë, PSH konstaton se në këtë rast si pjesë e kriterëve kualifikuese ka qenë edhe kërkesa si në vijim:

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit. Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 6 te DT.

Ndërsa dëshmia e kërkuar dokumentare lidhur me këtë kërkesë ka qenë:

Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytezimin, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per shfrytezim.

Lidhur me këtë, OE ankues në ofertën e tij ka paraqitur një kontratë për groposjen e qeneve, e datës 09.10.2019, që në përmbajtën e saj si lëndë e kësaj kontrate palët lidhin marrëveshje që kryesi i punimeve të bëjë groposjen dhe mbulimin dhe të qeneve, sipas kërkesave të porositisit në vendin që cakton Drejtoria e Bujqësisë në Komunën e Ferizajit,

Andaj duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar në ofertën e tij, PSH konstaton se OE nuk ka paraqitur asnjë të dhënë apo dëshmi në ofertën e tij që dëshmon përmbushjen e kriterit/kërkesës së lartpërmendur, përkatësisht lidhur me pajisjet sipas aneksit 6, konkretisht eskavatorin, lidhur për të cilin në kontratën e paraqitur nuk është evidentuar asnjë e dhënë që saktësojnë apo tregojnë përmbushjen e ofertës lidhur me DUD-in, kontrata apo fatura e blerjes, e as në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, në këtë marrëveshje të dorëzuar në këtë ofertë nuk është evidentuar asnjë e dhënë lidhur me këtë pajisje (eskavatorin).

Duke qenë se kriteri i lartpërmendur ka qenë kriter kualifikues, PSH konstaton se në këtë rast OE ankues nuk ka paraqitur dëshmi të kërkuara nga AK, andaj edhe pse i njëjti ka paraqitur dokumentacionin e plotësuar me ndryshime të kontratës bazë, PSH konstaton se këto dokumente nuk mund të merren për bazë për shkakun se në këtë rast konsiderohen si ndryshim material i ofertës, andaj PSH vlerëson se me qenë se në lidhje me eskavatorin kanë munguar dëshmitë në ofertë, dorëzimi i tyre në faza të mëvonshme është i papranueshëm, kështu që oferta e OE ankues klasifikohet si e papërgjegjshme.

Sipas Nenit 56 të LPP, një OE do të konsiderohet i kualifikuar për pjesëmarrje në aktivitet të

prokurimit nëse:

- a. Një OE vërteton të jetë i përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues dhe
- b. Një OE i tillë, në rast që AK ka përcaktuar kërkesa minimale për kualifikim, përmbush kërkesat e tilla dhe e dëshmon atë duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues në përputhshmëri me nenet 64 deri në 69 të LPP-së.

Andaj, paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit dhe shoshitjes së provave në tërësi konstaton se ankesa e GOE ankues, n.sh “Ambulanca Veterinare Indriti” & “Ambulanca dhe Farmacia Veterinare Goni” klasifikohet si e pa bazuar për faktin se dokumentacioni i kërkuar në DT dhe NJK nuk është paraqitur fare në ofertën e OE ankues, kështu që rrjedhimisht të gjeturat e ekspertit kanë qenë të papranueshme për faktin se sikur të merreshin në konsideratë dokumentet e plotësuar pas ofertimit, kjo do të binte ndesh përveç tjerash edhe me tiparet themelore të LPP-së, që janë diskriminimi, trajtimi i barabartë, e poashtu me konsistencën e vendimeve të bordit aktual ku si objekt shqyrtimi ka qenë situata e njejtë (në rastet kur nuk janë dorëzuar dokumentacioni fare rrjedhimisht ka qenë e pamundur të aplikohet neni 72 i LPP-së).

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Agon Ramadani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna Lipjan

1x1 GOE n.sh “Ambulanca Veterinare Indriti” & “Ambulanca dhe Farmacia Veterinare Goni”, me seli në Ferizaj

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.